



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2021:049497
Datë: 09.12.2024
Numri i dokumentit: 06568059

C.nr.160/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA E GJYKATËS NË VITI-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Raif Fazliu, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a.(KEDS) me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Klinton, nr.5, të cilën me autorizim e përfaqëson D.R. nga zyra ligjore pranë Distriktit në Gjilan, kundër të paditurit N.T.(R.) nga P. i Vitisë, të cilin me autorizim e përfaqëson E.S. avokat në Viti, për kompensimin e dëmit në vlerë prej 4,661.25 euro, pas mbajtjes së seancës kryesore në prani të përfaqësuesve të palëve me datë 27.11.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a.(KEDS) me seli në Prishtinë, kundër të paditurit N.T.(R.) nga P. i Vitisë, përmes së cilës ka kërkuar nga i padituri t`ia kompensojë dëmin material në shumë prej 4,661.25 €, për shfrytëzimin në mënyrë të paautorizuar të energjisë elektrike në njëhisorin elektrik me nr.35257054.

II. Detyrohet paditësja KEDS që t`ia kompensojë të paditurit N.T.shpenzimet e procedurës prej 135 €, në emër të përfaqësimit të avokatit në një seancë gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a.(KEDS) me seli në Prishtinë, ka parashtruar padinë për kompensimin e dëmit material, në emër të shfrytëzimit në mënyrë të paautorizuar të energjisë elektrike në njëhisorin elektrik me nr.35257054, duke e paditur N. R. T. nga P. Komuna e Vitisë.

Sipas Aktgjykimit Penal të formës së prerë të nxjerr nga Gjykata Themelore në Gjilan P.nr.195/17, i datës 03.05.2019, ndërsa i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAI.nr.785/19, i formës së prerë nga data 29.09.2019, i padituri është liruar nga akuza, mirëpo për dëmin e shkaktuar paditëses si e dëmtuar, është udhëzuar në kontest civil, për shkak të veprës penale “ndryshimi i njëhësorëve” e paraparë me nenin 320 të KPRK-së, duke e shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të pa autorizuar, ku njëhësori elektrik me nr.3257054, pllombat

shtetërore i ka pasur të manipuluar, respektivisht të hapura dhe prap të mbyllura, duke e loogarithur se i padituri i ka shkaktuar dëm paditëses në shumë prej 4,661.25 €.

Gjykata të paditurit N.T. i ka dërguar padinë e paditëses, i cili në fillim të përgjigjes është thirr në nenin 357 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), respektivisht në parashkrimin e kërkesës së paditëses, i cili nen thotë: *1. "Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite, nga data kur i dëmtuari ka marr në dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin",* ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni thuhet; *"Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit."*

Paditësja pretendon se dëmi iu është shkaktuar gjatë muajit Prill 2014, ndërsa padinë e ka ushtruar me datë 12.03.2021, apo pas 7 viteve pasi që iu është shkaktuar dëmi. Edhe me dy aktgjykimet i padituri është vërtetuar se nuk ka kryer veprë penale që i vihej në barrë.

Në seancën kryesore të datës 27.11.2024, përfaqësuesi i paditëses KEDS, D.R., ka thënë se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë për dëmin e shkaktuar material nga i padituri N.T., në vlerë prej 4,661.25 euro. Paditësja si palë e dëmtuar me kohë ka ngritur kallëzim penal kundër të paditurit, për shkak se i padituri me qëllim të pasurimit të kundërligjshëm, kshte shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të pa autorizuar, ku njehsori elektrik me numër 35257054, pasi ishte dërguar për kalibrim në Prishtinë, ishte konstatuar se blloibat shtetërore i kishte të manipuluar dhe numeruesi i njehsorit i manipuluar dhe kishte gjurmë të gërvishjes në numratar, ku me këto veprime paditësi ishte dëmtuar. I padituri në procedurë penale është liruar nga akuza, mirëpo gjykata për dëmin e shkaktuar, paditësen e kishte udhëzuar në kontest civil, ndërsa sa i përket lartësisë së dëmit, të paditurit i është llogarithur për 12 muaj, për shkak se kemi të bëjmë me konsumator komercial. Gjykatës i ka paraqitur si provë Transaksionin e Konsumatorit dhe Vendimin e ZRRE-së te vitit 2009, andaj mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të miratohet e bazuar. Sa i përket përgjigjes në padi të njëjtën e ka kundërshtuar nga fakti se dëmi është shkaktuar me veprë penale, duke u mbështetur në nenin 358 të LMD-se, ku parashkrimi rrjedh nga dita e marrjes se vendimit nga Gjykata e Apelit, duke konsideruar se nga nga kjo datë rrjedh afati i parashkrimit, në padinë e kemi parashtruar me kohë dhe për dëmin e shkaktuar me veprë penale parashihet një afat më i gjatë, do të thotë dyfishi i kohës.

I padituri N.T., si pronar i lokalit "EURO - DINI" kur ekipet e terrenit kanë shkuar për ti shënuar pajisjet elektrike me datë 29.08.2013, ku edhe me trasnkacionin DGL-9015575, vërtetohet se është i njejt i pronar, i padituri me datë 02.09.2021, kur ka bërë pagesë në shumë prej 389 euro, nga shuma e pergjithshme prej 4,797.91 euro, dëmi ishte zvogëluar në 4,408.41 euro, pastaj me pagesat e datës 05.10.2021, në shumë prej 393.50 euro dhe ajo e datës 09.11.2021, në shumë prej 496 euro, si dhe pagesa e datës 09.12.2021, në shumë prej 500 euro, me anë të këtyre pagesave ku i padituri borxhin e përgjithshëm duke përfshirë edhe dëmin e shkaktuar e ka zvogëluar në shumë prej 4,298.07 euro edhe pse në pagesë nuk ka specifikuar si rikthim i humbjes tek borxhi i përgjithshëm, duke u mbështetur në transaksion vërtetohet se i padituri e ka paguar një pjesë të dëmit të shkaktuar dhe në këtë mënyrë i padituri vërtetohet se e ka pranuar dëmin në tërësi.

Përfaqësuesi i të paditurit N.T., av. E.S., duke mbetur pranë përgjigjes në padi e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se paditësja me padinë e parashtruar në gjykatë për shpërblimin e dëmit kinse të shkaktuar fillimisht e pa qartë është koha, pastaj edhe si është shkaktuar dëmi, andaj në këtë fazë të procedurës ishte thirrur në nenin 357 të LMD-se, lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses. Sipas këtij neni në paragrafin 1 të këtij neni thuhet që kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për 3 vite, nga

data kur i dëmtuari ka marr dijeni për dëmin dhe për personin i cili e ka shkuara dëmin. Nga provat që sapo u dorëzuan nga përfaqësuesi i paditësit me numër DGL-9015575, vërtetohet se dëmi i pretenduar është shkaktuar nga 08 janar 2014, ndërsa padia e paditësit është parashtruar me date 16 mars 2021, apo i bie mbi 7 vite, pasi që ishte shkaktuar dëmi, që është në kundërshtim me të gjitha normat, përkatësisht me dispozitën e nenit 357.2 të LMD-se, i cili njëherit është afat i përgjithëm i parashkrimit edhe për rastet për të cilat nuk rregullohet me dispozita të veçanta ndonjë formë e kompensimit të dëmit.

Po ashtu paditësi me kërkesëpadinë e tij si parë ka paraqitur dy aktgjykime penale, duke kërkuar kompensimin e dëmit, edhe pse në bazë të këtyre aktgjykimeve i padituri është liruar nga përgjegjësia penale, respektivisht nga akuza. Përmes këtyre vendimeve është vërtetuar se i padituri nuk ka qenë fajtor dhe nuk ka shkaktuar veprë penale- dëm të paditurës, duke konsideruar se paditësi me asnjë provë të vetme përpos kërkesë së parashkruar nuk e ka vërtetuar se dëmin që kinse i ka shkaktuar i padituri, sepse me vendime penale nuk është vërtetuar kushti themelor fajësia, por as dëmi i shkaktuar, të cilat kushte nuk janë vërtetuar në asnjë rast.

Lidhur me pretendimet se i padituri paska paguar një pjesë të borxhit dhe kështu e ka pruar dëmin, nuk është e vërtetë se i padituri ka paguar faturën me datë 10.02.2015, dhe një faturë me datë 25.06.2021, që i bie koha pas 7 viteve duke mos e ditur se çka ishte duke paguar, paditësja nuk e ka precizuar pagesën se çka është duke paguar i padituri, por kjo pagesë ishte bërë në emër të faturës mujore, e cila rendon edhe tani duhet të paguhet.

Palët ishin pajtuar dhe kishin propozuar leximin dhe administrimin e provave, ashtu që ishin lexuar provat si: Aktgjykimi penal P.nr.195/2017, i datës 03.05.2019, ndërsa i plotfuqishëm me 29.08.2019, Aktgjykimi penal PA1.nr.785/2019, i datës 29.08.2019, i nxjerr nga Gjykata e Apelit të Kosovës, Fatura e lëshuar nga KEDS, nr. 2276, e datës 03.01.2014, në emër të konsumatorit "Euro- Dini" N.T., Fatura e datës 08.01.2014, në emër të konsumatorit "Euro- Dini" N.T., Transaksionet e konsumatorit, me nr. DGL 9015575, në emër të konsumatorit "Euro- Dini" N.T.(R.), e nxjerr me datë 27.11.2024, e cila përmban borgjin total 5,014.54 euro dhe Vendimi numër 612 i datës 28.07.2009, i nxjerr nga Bordi i ZRRE-se, për Energji. Provat nuk ishin kundërshtuar nga palët.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditëses KEDS, D.R., ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditëses ta paroj si të bazuar dhe të detyrohet i padituri në permbushjen e dëmit material në shumë prej 4,661.25 euro, si dhe shpenzimet e procedurës në emër të pagesës së taksës për padi të paguaj i padituri shumë prej 40 euro.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i të paditurit N.T., av. E.S., ka mbetur pranë përgjigjes në padi dhe thenieve si në procesverbalin e seancës kryesore, duke kërkuar që gjykata kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar, për shkak të parashkrimit të saj. Në emër të shpenzimeve të procedurës ka kërkuar 135 €, për një seancë të përfaqësimit të tij si avokat.

Gjykata në kuptim të nenit 8 të LPK-së duke i vlerësuar provat veç e veç dhe si tërësi, konstaton se:

- Me Aktgjykimin penal P.nr.195/2017, i datës 03.05.2019, ndërsa i plotfuqishëm me 29.08.2019, vërtetohet se i akuzuari N. R. T. nga P. i Vitisë, ishte liruar nga akuza për veprën penale me të cilën ishte akuzuar se në mënyrë të pa autorizuar kishte shfrytëzuar energjinë elektrike, ashtu që në brendi të njehsorit elektrik nr.35257054 pllombat shtetërore i kishte manipuluar, duke i hapur dhe mbyllur të njëjtat prej datës të pa vërtetuar deri më datë 27.11.2013.

- Të njëjtin vendim e kishte vërtetuar Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PA1.nr.785/2019, i datës 29.08.2019, me të cilin ishte refuzuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjiilan.

- Fatura e lëshuar nga KEDS, nr. 2276, e datës 03.01.2014, në emër të konsumatorit ‘‘Euro-Dini’’ N.T.dhe Fatura e datës 08.01.2014, në emër të konsumatorit ‘‘Euro- Dini’’

N.T., përveç se legjitimojnë palën pasive, e fundit vërteton se i padituri në emër të rikthimit të humbjeve deri me datë 08.01.2014, kishte realizuar pagesën prej 334.86 €.

- Transaksionet e konsumatorit, me nr. DGL 9015575, në emër te konsumatorit ‘‘Euro- Dini’’ N.T.(R.), e nxjerr me datë 27.11.2024, e cila përmban borgjin total 5,014.54 euro, vërtetojnë pretendimet e palës së paditur se pas datës 08.01.2014 (apo qysh para 7 viteve e 3 muaj), i padituri asnjëherë nuk kishte bërë pagesa në emër të detyrimit të grumbulluar për shkak të pretendimeve të paditëses se kinse i padituri në mënyrë të pa autorizuar kishte shfrytëzuar energjinë elektrike, por sipas këtij transaksioni shihet se i padituri kishte bërë pagesa të rregullta të faturuara për konsumin e energjisë elektrike.

Gjykata, pas analizimit dhe shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë së paditëses, ka vendosur në mënyrë meritore, duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar në prova e fakte, por edhe për shkak të parashkrimit të saj.

Pretendimet e palës paditëse se kërkesëpadia është bazuar në përgjegjësinë subjektive në bazë të fajit të paditurit, dolën të jenë të pabazuara, pasi që me Aktgjykimin penal P.nr.195/2017, i datës 03.05.2019, ndërsa i plotfuqishëm me 29.08.2019, të cilin e vërteton Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PA1.nr.785/2019, të datës 29.08.2019, i padituri N. R. T. nga P. i Vitisë, ishte liruar nga akuza për veprën penale me të cilën ishte akuzuar se në mënyrë të pa autorizuar kishte shfrytëzuar energjinë elektrike, ashtu që në brendi të njehsorit elektrik nr.35257054 pllombat shtetërore i kishte manipuluar, duke i hapur dhe mbyllur të njëjtat prej datës të pa vërtetuar deri më datë 27.11.2013.

Po ashtu pretendimi tjetër i paditëses se i padituri me datë 02.09.2021, kur ka bërë pagesë në shumë prej 389 euro, nga shuma e pergjithshme prej 4,797.91 euro, dëmi ishte zvogëluar në 4,408.41 euro, pastaj me pagesat e datës 05.10.2021, në shumë prej 393.50 euro dhe ajo e datës 09.11.2021, në shumë prej 496 euro, si dhe pagesa e datës 09.12.2021, në shumë prej 500 euro, ku sipas saj i padituri e ka paguar një pjesë të dëmit të shkaktuar dhe në këtë mënyrë e ka pranuar dëmin në tërësi, janë të paqëndrueshme dhe jo reale, sepse sipas Transaksionit të Konsumatorit në të gjitha këto raste/pagesa, askund nuk shkruan se pagesat janë kryer në emër të rikthimit të humbjeve (siç është ndërtuar padia e paditëses), në secilin rast shkruan ‘‘**faturë-pagesa e energjisë elektrike.**’’, e jo rikthimi i humbjeve.

Ndërsa, nëse i referohemi pagesës së datës 08.01.2014 (apo para 7 viteve e 3 muaj para ngritjes së padisë në gjykatë me datë 16.03.2021), konstatohet se kërkesa e paditëses e ushtruar pas mbi 7 viteve është e parashkruar, bazuar në nenin 357 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), respektivisht në parashkrimin e kërkesës së paditëses, i cili nen thotë: *1. ‘‘Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite, nga data kur i dëmtuari ka marr në dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin’’,* ndërsa me paragrafin 2. të këtij neni thuhet; *‘‘Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit.’’*

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e bazoi në nenin 452.1 të LPK-së dhe Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës. Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA E GJYKATËS NË VITI

C.nr.160/2021, më 27.11.2024.

G j y q t a r
Raif Fazliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ushtrimi i ankesës në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afatin prej 15 ditësh, nga dita e pranimet të aktgjykimit, përmes kësaj gjykate.